FERIZAJ

Në spitalin e Ferizajt realizohet edhe një operacion me sukses

BY FERIZAJPRESS
MAY 29, 2017

Në Spitalin Rajonal të Ferizajt është realizuar me sukses një ndërhyrje kirurgjikale në bashkëpunim të mjekëve nga spitali i Ferizaj dhe ai i Shkodrës. Pacientja ishte diagnostikuar me diagnozë: Stenosis pyeloureteris lat. dex. Anomali e komunikimit te veshkës me ureterin – kanalin ujëderdhës që për pasoje mund te sjell deri te dëmtimi serioz i veshkës – humbje te saj dhe sipas mjekëve specialistë është vlerësuar se pacientja duhet t'i nënshtrohet operimit. Operacioni u realizua me sukses. Ky realizim është falë ekipit kirurgjikal nga Spitali i Ferizajt, Dr. Imri Vishi, Dr. Driton Ferizi dhe Dr. Agon Bislimi dhe kirurgut nga Shkodra, Dr. Gëzim Galiqi. Qyteti i Ferizajt është binjakëzuar me qytetin e Shkodrës dhe ky binjakëzim më së miri po funksionon në lëmin e shëndetësisë. Pritet që edhe në të ardhmen të ketë bashkëpunime të tjera në këtë drejtim.